

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vera 2026 rriti numrin e turistëve, por shtoi pikëpyetjet
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/vera-2026-rriti-numrin-e-turisteve-por-shtoi-pikepyetjet-i105063
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 06:35:28 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 06:17:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4c1984c92c5be4677e85578f0879f2178e50f9266776c5fe6dc261cf5f966779
TEKSTI	fc0ed7287e6066847ebc4e008d4e69cf79c8924187a7f9661fc83b8501877182
PAMJA	7fe42de93a44292fcb20d5456158ec36bdd68a38f35d896407604781e56108f7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ab7e8af19b234b011f27e5175761a80d6e63db176c06639940ece0b8a6d013e1
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a94744ba6f340a0d35e86c725f9a3ff2353c45c48cf148fa90ea824c18d037c8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ab7e8af19b234b011f27e5175761a80d6e63db176c06639940ece0b8a6d013e1>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash:

kanë rezervuar viet në riu

je i denjë ose

resnje shiu parashikimi i motit për

Moti parashikohet fillimi...

se Piranjava prek personazhet

bijes se dëshmorit të UÇK-

Simeone përballë

serish në pankina, duke

Asgje nuk e nxin

komunikim në rrjetin social këtë të

të ë

AKTUALITET

Vera 2026 rriti numrin e turistëve, por shtoi pikëpyetjet

Piranjat Përditësimi i fundit 20 Shtator 2026, 08:17



Vera 2026 po sjell më shumë turistë, por operatorët ngrenë pikëpyetje sesa kjo rritje do të përkthehet në të ardhura më të larta. Vizitorët po bëjnë rezervime të momentit të fundit, po qëndrojnë më pak dhe po tregohen më të kujdesshëm me shpenzimet. Në të njëjtën kohë, shërbimi më i dobët, mungesa e stafit të kualifikuar, trafiku dhe infrastruktura mbeten ndër problemet më të dukshme të sezonit. Çmimet dhe raporti me cilësinë po ndikojnë gjithashtu në sjelljen e turistëve, sidomos në Jug. Në sfond, vonesa e Aeroportit të Vlorës ka lënë pezull plane dhe kontrata për turizmin e organizuar.

Ndryshe nga sa nisi, sezoni veror i këtij viti po mbyllet me një tablo pozitive për turizmin. Pas një qershori të zbehtë, flukset e të huajve që hynë në vend në korrik dhe gusht, e me shumë gjasa edhe në shtator, kanë shfaqur rritje të qëndrueshme.

Zgjatja e sezonit deri në 10-ditëshin e parë të tetorit sikurse konfirmohet nga operatorët turistikë është një tjetër tregues se Shqipëria po vazhdon të mbajë ritmin, duke mbetur në radarin e vizitorëve.

Kontratat me garanci për turizmin e organizuar të vitit 2027 janë mbyllur me rritje në volum dhe çmim. Por pas rritjes së numrave, industria po ngre pikëpyetje mbi problemet që këtë vit ishin më të dukshme se një vit më parë.





“Ecuria deri tani është e mirë. Nëse flasim për numrat, ka një rritje”, thotë kreu i Unionit Turistik Shqiptar, Rrahman Kasa. Sipas tij, vetëm fundi i sezonit mund të tregojë se çfarë vlere ka sjellë kjo rritje.

“Mbetet për t’u parë se çfarë do të sjellë kjo në të ardhura, pra nëse do të kemi më shumë të ardhura se vitin e kaluar dhe sa do të jetë kjo rritje.”

Edhe Elvis Kotherja, themelues i “Elite Travel Group & Elite Hospitality”, e konsideron sezonin të mirë nëse ndalemi vetëm në sipërfaqe të shifrove.

Por ajo që i bie më shumë në sy është ndryshimi në sjelljen e klientëve që po shfaqet në disa tendenca sipas tij. Një pjesë e tregjeve po rezervojnë gjithnjë e më vonë. “Rezervojnë në momentin e fundit dhe kjo vërehet shumë qartë në të gjitha tregjet perëndimore. Çekia, Gjermania dhe tregje të tjera e kanë këtë tendencë, ndërsa Franca është disi më e organizuar dhe rezervon më herët.”

Ndryshimi i dytë lidhet drejtpërdrejt me shpenzimin. “Hezitojnë të konsumojnë. Dikur kanë qenë shumë më mirë sa u përket shpenzimeve”, thotë z. Kotherja.

Z. Kasa sheh një profil të ngjashëm. Sipas tij, pjesa më e madhe e turistëve që po vizitojnë Shqipërinë vazhdojnë t’i përkasin kategorisë me fuqi të mesme ose të ulët shpenzuese.

“Nuk e kemi ende atë luks që të kemi një profil turistësh me fuqi të lartë shpenzuese”, thotë ai. Sipas vlerësimit të tij, “60 për qind ose më shumë janë turistë ‘low cost’, pra turistë me buxhet të ulët, që duan të shpenzojnë pak”.

Një pjesë e tyre janë udhëtarë që kërkojnë destinacione të reja dhe që e zgjedhin Shqipërinë edhe për shkak të kostos. “Kjo është ajo kategori turistësh që nuk do të shpenzojë shumë, sepse përparësi ka eksplorimin me një kosto sa më të ulët”, thotë z. Kasa.

Tendenda për të kontrolluar shpenzimet shihet edhe në mënyrën e qëndrimit. Z. Kotherja vëren rritje të akomodimit në apartamente dhe shtëpi private dhe një përdorim më të madh të formulës “self-catering”.

“Këtë vit të huajt vijnë dhe qëndrojnë më pak. Ka vazhduar të rritet akomodimi privat, pra apartamentet dhe shtëpitë në platforma si Booking apo Airbnb, si dhe ‘self-catering’, pra ushqimet që blihen në supermarket dhe gatohen në shtëpi.” Sipas tij, një pjesë e kësaj sjelljeje lidhet me raportin mes çmimit dhe cilësisë.

“Kjo ka ardhur si efekt i çmimeve, të cilat në disa raste nuk bëjnë sens në raport me cilësinë.”

Shërbimi, pika e dobët e sezonit

Nëse rritja e numrit të turistëve është pjesa pozitive e bilancit, cilësia e shërbimit është një nga shqetësimet që bashkon më qartë vlerësimet që mbizotërojnë në këtë sezon si në rrjete sociale e platforma të pavarura të udhëtimit, edhe mes përfaqësuesve apo operatorëve të sektorit.

Kreu i Unionit Turistik e rendit shërbimin ndër problemet kryesore që raportohen nga turistët dhe agjencitë e huaja. “Shërbimet lënë për të dëshiruar dhe kjo ka bërë punën e vet në vlerësimet që marrim nga të huajt, sidomos në rrjetet sociale apo nëpër platforma”, thotë ai.

Sipas tij, problematika është veçanërisht e lidhur me mungesën e stafit të kualifikuar. “Mungesa e stafit të kualifikuar në këtë sektor është një problem shumë i madh, që na penalizon.”

Z. Kotherja është po aq i drejtpërdrejtë në vlerësimin e tij për sezonin. “Nga eksperiencia ime, këtë vit mendoj se shërbimi ka çaluar.” Ai e lidh këtë me presionin e kostove mbi bizneset.

Kur shpenzimet rriten, sipas tij, bizneset gjenden përballë zgjedhjes për të kursyer ose te produkti, ose te stafi. “Për të mbijetuar, të duhet të çalosh ose në cilësinë e produktit, ose në staf. Por kjo nuk është zgjidhje.”





Problemi i punonjësve, sipas z. Kotherja, nuk kufizohet vetëm te mungesa në numra. Ai e sheh atë edhe si çështje të produktivitetit dhe të raportit mes aftësisë dhe pagës. Mungesa e fuqisë punëtore gjatë viteve të fundit, sipas tij, ka ushtruar presion të fortë mbi pagat, përfshirë edhe ato të punonjësve pa kualifikimin e nevojshëm.

“Kjo mangësi që kemi pasur ka shkaktuar rritje të pagave edhe për punonjës të pakualifikuar, pra këta të fundit janë mbiçmuar, duke e futur sektorin në një rreth vicioz pa zgjidhje”, thotë ai.

Për një industri ku kontakti i drejtpërdrejtë me klientin është pjesë e produktit, problemet e stafit reflektohen menjëherë tek eksperiencia e turistit. Z. Kotherja e lidh këtë edhe me disiplinën, përgjegjësinë dhe mënyrën se si organizohet puna. Sipas tij, disa struktura turistike tashmë po orientohen drejt punonjësve të huaj.

“Do të vijë momenti kur të huajt në hotele do të dominojnë si fuqi punëtore. Kjo nuk shmanget”, thotë ai. “Ka aktualisht struktura që nuk duan të punojnë me shqiptarë, për shkak të disiplinës, rregullit dhe përgjegjësisë.”

Një mundësi për të zbutur mungesën e punonjësve, sipas tij, mund të vijë nga marrëveshjet për punësimin e shtetasve nga vendet aziatike. “Ka një shpresë dhe një dritë në fund të tunelit që lidhet me fuqinë punëtore pas disa marrëveshjeve me vendet e Azisë të cilat mund të sjellin një fuqi punëtore të kualifikuar.”

Z. Kotherja ngre gjithashtu një problem tjetër që, sipas tij, lidhet me profesionalizimin e industrisë: përdorimin e teknologjisë. “Kjo industri duhet automatikisht të digjitalizohet”, thotë ai, duke theksuar se një pjesë e menaxherëve vazhdojnë ta shohin teknologjinë më shumë si barrë sesa si mjet për rritjen e produktivitetit.

Për z. Kasa, pasojat e dobësive në shërbim shfaqen në vlerësimet që turistët lënë në platforma. Dhe në bregdet, ku presioni i flukseve është më i madh, ky problem bëhet më i dukshëm. “Në Shqipëri nuk është vetëm fluksi apo menaxhimi. Problem janë edhe shërbimet, të cilat lënë për të dëshiruar.”

Trafiku, infrastruktura dhe çmimet

Në listën e problemeve të sezonit, infrastruktura dhe trafiku zënë një vend të rëndësishëm. Z. Kasa i rendit ato mes dy shqetësimeve kryesore të përcjella nga agjencitë e huaja.

“Dy janë përshypjet kryesore negative: e para është infrastruktura dhe e dyta, trafiku tepër i rënduar në rrugët tona”, thotë ai.

Në raste të caktuara, trafiku ka sjellë vonesa të konsiderueshme edhe në distanca relativisht të shkurtra. “Gjatë kësaj vere na është dashur që, nga Aeroporti i Tiranës deri në Golem, të bëjmë transfera që kanë zgjatur edhe katër orë apo katër orë e gjysmë”, thotë z. Kasa.

Këto transfera, sipas tij, lidhen me turistët e organizuar që mbërrijnë me fluturime charter.

Z. Kotherja e konsideron problemin më të përqendruar në disa segmente të caktuara. Ai veçon aksin Tiranë-Elbasan, i cili sipas tij penalizon Juglindjen, si dhe segmentin Milot-Lezhë, që rëndon lëvizjen drejt Veriut.

“Në pjesën tjetër nuk ka qenë shumë keq. Kuptohet që, në sezon, flukset rriten dhe mund të ketë edhe trafik, por infrastruktura në vetvete nuk mund të them se është problem. Trafiku në disa segmente, po.”

Në Jug, problemet e aksesit kombinohen edhe me presionin e ndërtimeve dhe çmimeve. Z. Kasa vëren se, krahasuar me Durrësin, bregdeti i Jugut vijon të marrë vlerësime më të dobëta. “Durrësi është më mirë, ndërsa Jugu është më keq. Edhe infrastruktura në Jug është më e rënduar, diçka që e penalizon.”

Një problem tjetër janë kantieret e ndërtimit në zonat turistike. “Në Jug, por edhe në bregdet në përgjithësi, problem mbeten kantieret dhe vinçat mbi kokën e pushuesve, diçka që nuk na jep pikë pozitive”, thotë z. Kasa.

Ndërkohë, z. Kotherja e sheh rritjen e çmimeve si një nga çështjet që mund të ndikojë më shumë te konkurrueshmëria. Ai e lidh atë me zhvlerësimin e euros dhe rritjen e kostove të biznesit. “Kur euro zhvlerësohet, e gjithë industria fillon të rrisë çmimet dhe harron se një pjesë shumë e madhe e klientëve në vend janë ata që paguajnë në euro, përfshirë edhe klientët nga Kosova.”

Sipas tij, kjo po i bën turistët më të kujdesshëm dhe po rrit mundësinë që ata të zgjedhin destinacione alternative. “Klientët duan më të lirën dhe Shqipëria nuk është më edhe aq e lirë.”

Nga ana tjetër, z. Kasa e konsideron rritjen mesatare të çmimeve të moderuar dhe të lidhur me kostot. “Çmimet kanë pasur rritje të lehtë dhe ka qenë një rritje e pranueshme në kushtet e rritjes së kostove”, thotë ai, duke bërë të qartë se nuk u referohet rasteve individuale ku mund të ketë abuzime.

Por në zona të veçanta të Jugut, z. Kotherja sheh një problem më të fortë. Duke iu referuar Dhërmiut, ai thotë se çmimet e larta kanë kufizuar praninë e klientëve të huaj. “Kam qenë vetë në Dhërmi dhe nuk ka klientë të huaj aq sa pritej, sepse çmimet janë shumë të shtrenjta.

Një i huaj nuk paguan në afatgjatë çmime prej 400 eurosh/nata.”

Një sezon me rritje por edhe me pikëpyetje

Përtej problemeve të sezonit, pritshmëritë për vijimësinë e sektorit të turizmit mbeten relativisht pozitive. Kasa thotë se kontratat e turizmit të organizuar për vitin e ardhshëm janë mbyllur me rreth 10% rritje si në volum, ashtu edhe në çmim.

Polakët vazhdojnë të kryesojnë, të ndjekur nga çekët, ndërsa ai vëren rritje edhe nga tregu francez.

Edhe rezervimet e vjeshtës paraqiten mirë. “Turizmi i vjeshtës mendoj se do të jetë mirë, pasi që tani rezervimet janë në nivele të kënaqshme”, thotë z. Kasa.

Ndërsa z. Kotherja konfirmon rritjen për vjeshtën, megjithëse thekson se presioni i kostove vazhdon. Ai sheh gjithashtu ndryshim të interesit të turistëve drejt eksperiencave dhe destinacioneve jashtë modelit tradicional të detit dhe rërës.

“Të huajt prirën të shpenzojnë për eksperiencia. Më pak për ushqim dhe më shumë për eksperiencia”, thotë ai.

Në këtë drejtim, Berati, Gjirokastra dhe Veriu po marrin vlerësime të mira, ndërsa z. Kasa thotë se edhe Veriu kur flasim për bregdetin ka shënuar rritje të numrit të turistëve, pavarësisht se sezoni atje mbetet më i shkurtër.

Shqipëria, sipas tij, vazhdon të përfitojë edhe nga disa elemente që turistët i vlerësojnë pozitivisht: “kulinaria, mikpritja dhe natyra”./Monitor

Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 20 Shtator07:59

[Kthjellime dhe vranësira, në zonat malore priten reshje shiu, parashikimi i motit për sot](#)

Për ditën e diel, vendi ynë do të ndikohet nga kushte atmosferike relativisht të paqëndrueshme. Moti parashikohet fillimi...

AKTUALITET 19 Shtator23:16

[BB: Shqipëria shpenzon mbi nivelin e nevojshëm për ujë e kanalizime, por ujë 24 orë nuk ka](#)

Shqipëria rezulton ndër rastet e veçanta ku shpenzimet për furnizimin me ujë dhe kanalizimet janë më të larta se nivel...

AKTUALITET 19 Shtator22:47

[Përforcimi i themeleve të urës mbi lumin Mat, autoritetet kufizojnë lëvizjen e mjeteve të tonazhit të rëndë](#)

Ura mbi lumin Mat në aksin nacional Lezhë-Milot bërtit vendosur nën kufizim për automjetet me tonazh të rëndë. Au...

AKTUALITET 19 Shtator22:18

[414 kg hashash në frigoriferë e valixhe/ Arrestohet 29-vjeçari shqiptar në Itali, vlera e drogës në treg mbi 4 milionë euro](#)

Mbi 414 kilogramë hashash janë sekuestruar nga policia italiane gjatë një operacioni në Guidonia, pranë Romës, ndërsa n&...

AKTUALITET 19 Shtator22:11

[“Nesër më shumë”, mbyllet protesta e 112 kundër qeverisë](#)

Me thirrjet “Nesër më shumë”, “arrestoni Ramën”, “Shqipëria po bën revolucion”, është...

AKTUALITET 19 Shtator22:01

[Shqiptarët protestojnë edhe në Mynih kundër vendimit të Hagës](#)

Pas tubimeve të zhvilluara në Hagë, Prishtinë dhe Cyrih, shqiptarët janë mbledhur në protestë edhe në Mynih të...

AKTUALITET 19 Shtator21:26

[Vazhdon protesta edhe në Divjakë, 51 ditë rezistencë kundër shkrirjes së bashkisë](#)

Prej 51 ditësh, banorët e Divjakës vijojnë protestat kundër reformës së re territoriale që, sipas tyre, rrezikon të...

AKTUALITET 19 Shtator21:18

["Më 8 tetor tek Kuvendi", protestuesi thirrje qytetarëve: S'do lejojmë Edi Ramën të shkrijë bashkitë](#)

Një prej protestuesve u ka bërë thirrje të gjithë shqiptarëve që më 8 tetor të jenë para parlamentit për ...

AKTUALITET 19 Shtator21:10

[Nga krimi i organizuar, dronet e deri te ekstremizmi, përfaqësues të FBI-së takojnë elitën e sigurisë në Tiranë](#)

Këto ditë Tirana është bërë qendra e një takimi të rëndësishëm të drejtuesve dhe ekspertëve t&e...

AKTUALITET 19 Shtator21:02

[Dyshohet se u vetëhelmua me pesticide, humb jetën në spital 27-vjeçari në Tiranë](#)

Një 27-vjeçar ka humbur jetën në Tiranë, pasi u dërgua në spital në gjendje të rëndë shëndetë...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 19 Shtator

[Dy turiste suedeze në Tiranë: Ftuan në shtëpi 3...](#)

Dy turiste nga Suedia, që kishin mbërritur në Tiranë në 4 shtator 2026, pretendojnë se janë abuzuar seksualisht nga 5 djem, t...

AKTUALITET 19 Shtator

[Të shtëna me armë në një kantier ndërtimi në Ti...](#)

Të shtëna me armë zjarri janë regjistruar në orët e para të mëngjesit në një kantier ndërtimi në T...

AKTUALITET 19 Shtator

[“Humbi të atin dhe dajën në luftë”/ Rrëfimi i g...](#)

Monologu i gazetares së Piranjave Edona Gashi, bijës së dëshmorit të UÇK-së, ka ngjallur reagime të shumta në r...

INVESTIGIME 19 Shtator14:14

[Pesë muaj pa të birin/ Nëna kërkon zbatimin e vendimit të gjykatës](#)

Në shumë raste, ndarja e një çifti me fëmijë të mitur shoqërohet me konflikte, përplasje e drama që godasi...

video





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.